

VENDIM
Nr. 611, datë 2.10.2024

PËR MIRATIMIN E UDHËRRËFYESIT PËR FUNKSIONIMIN E
INSTITUCIONEVE DEMOKRATIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Udhërrëfyesit për Funkcionimin e Institucioneve Demokratike, si dokument i politikave shtetërore, në kuadër të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ministria e Drejtësisë dhe ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin marrin masat për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të këtij udhërrëfyesi.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin dhe të gjitha institucionet, përgjegjëse për masat e përfshira në udhërrëfyes, për zbatimin e tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

UDHËRRËFYESI PËR FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE DEMOKRATIKE

ZONAT DHE NËNZONAT	MASA STRATEGJIKE/ LEGJISLATIVE / KORNIZA INSTITUCIONALE	ZBATIMI DHE KAPACITETI INSTITUCIONAL	PERFORMANCA
1. PROCESI ZGJEDHOR 1.1 Zgjedhje të lira dhe të ndershme Zhvillimi i përgjithshëm i zgjedhjeve.	Kuadri ligjor që adreson të gjitha vendimet përkatëse në pritje të Gjykatës Kushtetuese dhe rekomandimet e pagzjidhura të OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venecias miratohet përmes një konsensusi të gjerë ndërpartiak dhe procesi të hapur dhe gjithëpërfshirës konsultues miratohet brenda vitit 2026, duke adresuar ndër të tjera: - zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë para ligjit dhe profesionalizmit të administratës zgjedhore; - sigurimin e depolitizimit të komisioneve zgjedhore të niveleve më të ulëta; - votimin e shtetasve shqiptarë me banim të përhershëm jashtë territorit; - akuzat për blerje votash, për keqpërdorim dhe shpërdorim të burimeve administrative qendrore dhe vendore. Aspektet penale dhe civile të shpifjes janë plotësisht në përputhje me standardet evropiane.	Rritja e kapaciteteve dhe burimeve të KQZ-së dhe organeve të tjera kompetente për të zbatuar kuadrin ligjor të rishikuar dhe për të përballuar nevojat për të siguruar zhvillimin e duhur të përgjithshëm të zgjedhjeve në përputhje me legjislacionin e miratuar brenda vitit 2025, duke përfshirë, ndër të tjera, zbatimin e kuadrin ligjor të rishikuar për përdorimin e burimeve shtetërore në kuadër të zgjedhjeve. Digjitalizimi i proceseve të administrimit zgjedhor dhe mundësimi i votimit elektronik në një shkallë më të gjerë për të siguruar një kontroll kuptimplotë të pavarur publik të teknologjive zgjedhore, transparencë më të madhe dhe mbikqyrje publike mbi zgjedhjet brenda vitit 2027 në përputhje me standardet evropiane dhe rekomandimet e Komisionit. Zbatimi në kohë i programeve të edukimit të votuesve, duke përfshirë edukimin e votuesve në lidhje me votimin elektronik, të përshtatura për kategori të ndryshme zgjedhësish, duke përfshirë programet e edukimit personal të votuesve për romët, egjiptianët, grupet e tjera të cenushme dhe personat me aftësi të kufizuara përgjatë çdo cikli zgjedhor duke filluar nga viti 2025. Autonitetet vendore sigurojnë që të gjithë votuesit të informohen në kohën e duhur për vendin dhe kohën për shqyrtimin e listave të votuesve dhe vendndodhjen e qendrave të tyre përkatëse të votimit çdo cikël zgjedhor duke filluar nga viti 2025. Informacioni në kohë i votuesve për qendrat e votimit dhe listën zgjedhore duhet të bëhet përpara ose në kohë për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2025. Masat administrative parandaluese vendosen për të siguruar të dhënat personale të qytetarëve, përfshirë sigurimin dhe nga administrata zgjedhore dhe partitë politike në çdo cikël zgjedhor duke filluar nga	Adresimi i rekomandimeve të pagzjidhura të raporteve të OSBE/ODIHR për zgjedhjet e 25 prillit 2021 dhe zgjedhjet e tjera, rekomandimeve të Komisionit të Venecias, si dhe zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 38, datë 9.12.2022. Progresi i mëtjshëm në zbatimin efektiv në praktikë të së drejtës së votës nëpërmjet zbatimit të legjislacionit të rishikuar garantohej deri në vitin 2030. Transparenca përmes digjitalizimit dhe procedurave të zgjeruara, përmirësohet brenda vitit 2030. Trajtimi i barabartë para ligjit dhe mundësitë e barabarta në procesin zgjedhor duke u mundësuar të gjithë qytetarëve, përfshirë edhe grupet vulnerabel që të informohen për procesin sigurohet gjithnjë e më shumë brenda vitit 2030.

	<p>Aktet nënligjore detyruese të sjella në përputhje me legjislacionin parësor të miratuar në kohën e duhur brenda vitit 2025.</p> <p>Zbatohen vendimet në pritje të Gjykatës Kushtetuese për çështjet zgjedhore.</p>	<p>zgjedhjet e vitit 2025.</p> <p>Sigurohet zbatimi i rekomandimeve të pagzjidhura të OSBE/ODIHR dhe të Komisionit të Venecias, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - miratimin e masave administrative për të siguruar të dhënat personale të qytetarëve, përfshirë sigurimin dhe nga administrata zgjedhore dhe partitë politike në çdo cikël zgjedhor duke filluar nga zgjedhjet e vitit 2025. - Të drejtat e votës së personave me aftësi të kufizuara janë në përputhje me praktikën më të mira të BE-së dhe garantohen nga viti 2025 e në vazhdim. - Rritja e kapaciteteve të institucioneve mbikëqyrëse për monitorimin e keqpërdorimit të burimeve administrative gjatë fushatave zgjedhore nga zgjedhjet e vitit 2025. 	<p>Agjencitë ligjzbatuese rrisin përpjekjet për të identifikuar, hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e blerjes së votës – nga viti 2025 e në vazhdim.</p> <p>Qytetarët raportojnë dhe sigurojnë prova për çdo rast blerje vote apo presioni – në vazhdim.</p>
<p>1.2 Media në fushatën zgjedhore (Çështje të tjera që lidhen me lirinë e medias në përgjithësi të trajtuara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës) Ndër të tjera, të merren parasysh: rëndësia e medias së pavarur dhe pluraliste, roli vendimtar i transmetuesve të shërbimit publik, ndarja e aktiviteteve politike nga interesat e medias, mbrojtja e të drejtave investigative të gazetarëve dhe respektimi i pavarësisë së tyre editoriale, si dhe parandalimi i përdorimit të mundshëm të burimeve publike nga qeveritë dhe institucionet publike për të ndikuar në përmbajtjen mediatiqe.</p>	<p>Ndryshimet legjislative në Kodin Zgjedhor brenda vitit 2026, përmes një konsensusi të gjerë ndërpartiak dhe vullneti politik dhe një procesi të hapur konsultimi gjithëpërfshirës me qëllim që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - garantojnë mundësi të barabarta për të gjitha palët konkurruese për t'u qasur në media, duke përfshirë adresimin e hapësirës reklamuese dhe kufizimin e mbulimit të fushatës mediatiqe me materiale të gatshme të ofruara nga partitë politike, përfshirë monitorimin e mediave sociale, miratohen pas një procesi konsultimi publik dhe në përputhje me standardet dhe rekomandimet evropiane, duke përfshirë rekomandimet e OSBE/ODHIR dhe të Komisionit të Venecias. Ndryshimet ligjore për të forcuar efikasitetin, pavarësinë e rregullatorit të medias audiovizive do të miratohen në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias brenda vitit 2026. Korniza rregullatore e organeve të tjera që monitorojnë mediat online gjatë zgjedhjeve do të miratohet duke filluar nga viti 2026 e në vazhdim. 	<p>Rritja e sasiore dhe cilësore e monitorimit dhe profesionalizmit në raportimin mediatiq gjatë fushatës zgjedhore në çdo cikël zgjedhor, si dhe kapaciteteve të AMA-s për të kryer monitorimin në mënyrën e duhur, duke filluar nga zgjedhjet e vitit 2025, nëpërmjet zbatimit të projektit “Modernizimi i studios së monitorimit” nga AMA.</p> <p>Krijohen kapacitete për evidentimin e dezinformimit gjatë proceseve zgjedhore në çdo cikël zgjedhor, duke filluar nga zgjedhjet e vitit 2025, përfshirë target grupet përkatëse.</p> <p>Zbatimi i vazhdueshëm i mekanizmave të konsoliduar monitorues nga KQZ-ja në bashkëpunim me institucionet e tjera përkatëse mundësohet nga ndryshimet e Kodit Zgjedhor, që shqyrtojnë fushatën digjitale për keqinformim, manipulim dhe ndërhyrje të huaja duke vendosur teknologji të avancuara për analiza në kohë reale, duke bashkëpunuar me platformat e mediave sociale për të zbuluar dhe për të luftuar dezinformimin dhe për të nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar që synon adresimin e kërcënimeve ndërkufitare. – Në vazhdim.</p>	<p>Monitorimi i mbulimit të medias audiovizive zbatohet përmes përdorimit të studios së re të monitorimit nga AMA duke siguruar një sistem efektiv monitorimi cilësor dhe sasior të medias dhe dispozita të mbulimit neutral politik të medias gjatë gjithë zgjedhjeve, si dhe zbatimi i sanksioneve dekurajuese nga një organ i pavarur, është funksional brenda vitit 2030.</p> <p>Reziqet e dezinformimit adresohen gjithnjë e më shumë përmes masave të synuara brenda vitit 2030.</p> <p>Adresimi i rekomandimeve të pagzjidhura të raporteve të OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venecias për zgjedhjet e 25 prillit 2021 dhe zgjedhjet e tjera.</p> <p>Trajtimi në mënyrë progresive dhe efektive i dezinformimit gjatë fushatave zgjedhore, në përputhje me standardet dhe rekomandimet evropiane, duke përfshirë Komisionin e Venecias.</p>
<p>1.3 Financimi i partive politike dhe fushatave zgjedhore</p> <p>Kriteret për financimin publik dhe privat të partive politike; rregullat për donacionet private dhe shpenzimet e lidhura me fushatën zgjedhore; Transparenca e llogarive; mekanizmat e mbikëqyrjes dhe monitorimit të pavarur, duke përfshirë sanksione domethënëse efektive, proporcionale dhe bindëse për shkeljet.</p>	<p>Ndryshimet legjislative në Kodin Zgjedhor përmes një konsensusi të gjerë ndërpartiak dhe vullneti politik, dhe një procesi konsultimi të hapur dhe gjithëpërfshirës për financimin e partive politike në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it të miratuara brenda vitit 2027, duke përfshirë, ndër të tjera, zgjerimin e rregullave dhe kufizimeve për donacionet dhe shpenzimet për palët e treta, si dhe publikimin nga konkurrentët të të ardhurave dhe shpenzimeve të fushatës së tyre përpara ditës së zgjedhjeve.</p> <p>Amendamentet ligjore për financimin e partive politike do të miratohen deri në vitin 2027.</p>	<p>Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe financiare të KQZ-së për të zbatuar në mënyrë efektive kërkesat ligjore në lidhje me mbikëqyrjen dhe monitorimin e financave të fushatës brenda vitit 2025.</p> <p>Procesi i financimit të partive politike/raportimit online të partive politike, audituesve dhe monitoruesve digjitalizohet gjithnjë e më shumë për të mundësuar raportimin e shpejtë online dhe garantimin e transparencës në kohë reale mbi të ardhurat dhe shpenzimet në çdo cikël zgjedhor, duke filluar nga viti 2025.</p> <p>Platforma Digjitale për Raportimin Financiar të Partive Politike do të ofrojë qartësi të plotë duke publikuar automatikisht raportet financiare online me qëllim rritjen dhe sigurimin e saktësisë maksimale dhe garantimin e formateve të hapura të të dhënave për përdoruesit duke filluar nga viti 2025.</p> <p>Një set të dhënash raportimi lehtësisht të përpunueshme do t'iu ofrohet mediave dhe studiuesve të zgjedhjeve nga KQZ-ja dhe Shoqëria Civile duke filluar nga viti 2025</p>	<p>Adresimi i rekomandimeve të pagzjidhura të raporteve të OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venecias për zgjedhjet e 25 prillit 2021 dhe zgjedhjet e tjera.</p> <p>Auditimi mbi financimin e partive politike përmes krijimit të portalit të financimit konsolidohet ndjeshëm brenda vitit 2030.</p> <p>Sanksionet janë efektive për parandalues dhe proporcionale dhe zbatohen sistematikisht në rastet e shkeljeve të dispozitave për financimin e partive politike në çdo cikël zgjedhor, duke filluar nga zgjedhjet e vitit 2025.</p> <p>Rritje e vëmendjes publike për të ndjekur se si partitë politike do të rrisin llogaridhënien bazuar në setin e të dhënave raportuese lehtësisht të përpunueshme të ofruara nga KQZ-ja për OSHC-të, mediat dhe studiuesit e zgjedhjeve duke filluar nga viti 2025.</p>
<p>2. FUNKSIONIMI I PARLAMENTIT <i>Funksionimi i Kuvendit duhet të bazohet në parimin e transparencës dhe llogaridhënies, integritetit dhe efektivitetit.</i></p>			

<p>2.1 Transparenca dhe llogaridhënia</p> <p>Shkalla e transparencës së punimeve parlamentare; Aspektet horizontale (ndërinstitucionale) dhe vertikale (qytetarët) të llogaridhënies së Kuvendit</p>	<p>Ndryshimi i Kodit të Sjelljes së deputetëve, miratohet duke parashikuar detyrimin që takimet e deputetëve dhe të stafit të tyre me OSHC-të dhe lobistët të bëhen vetëm me ata që janë të regjistruar në Regjistrin e OSHC-ve dhe Regjistrin e Lobistëve të krijuar dhe përditësuar nga Kuvendi në përputhje me përcaktimet e vendimeve të Komisionit të datës 31 janar 2018 për Kodin e Sjelljes për Anëtarët e Komisionit Evropian, nen 7, si dhe publikimin e procesverbalit të mbledhjes brenda 2024.</p> <p>Ndryshimi i rregullores së Kuvendit duke shtirë kontrollin <i>post-legjislativ</i> jo vetëm mbi ligjet e përafuara me <i>acquis</i> të BE-së, por edhe në aktet e tjera si aktet normative që kanë fuqinë e ligjit deri në vitin 2024.</p> <p>Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies së Kuvendit.</p>	<p>Hartimi i metodologjisë për Kontrollin <i>post-legjislativ</i> dhe trajnimi i stafit të Kuvendit për zbatimin e tij brenda vitit 2025.</p> <p>Kapacitetet e stafit të Kuvendit do të forcohen për të përballuar përgjegjësitë e situara në lidhje me transparencën, që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit.</p> <p>Deri në vitin 2026 do të miratohet Plani Strategjik për Kuvendin (2026-2030), duke përfshirë masat mbi Planin e veprimit lidhur me forcimin e transparencës dhe llogaridhënies me fokus ndër të tjera në përmirësimin e: i) efektivitetit të ushtrimit të funksioneve përfaqësuese, legjislativë dhe mbikëqyrëse; ii) rolit të Kuvendit në proceset integruese dhe diplomacinë parlamentare; iii) pjesëmarrjes dhe edukimit qytetar në veprimtarinë e Kuvendit; iv) kuadrit rregullator, burimeve njerëzore dhe infrastrukturës etj..</p> <p>Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies së Kuvendit nëpërmjet:</p> <p>a) Qasjes më të lehtë dhe në kohë për publikun tek dokumentacioni zyrtar parlamentar, për shoqërinë civile, median, palët e tjera të interesuara dhe publikun e gjerë duke përmirësuar vazhdimisht informacionin e publikuar në faqen e Kuvendit brenda vitit 2028;</p> <p>b) Zbatimit sa më të shpejtë të një sistemi transkriptimi për mbledhjet e komisioneve parlamentare dhe seancat plenare brenda vitit 2028;</p> <p>c) Transmetimit në kohë reale dhe qasje në materialet audio-video të veprimtarisë parlamentare në çdo kohë nga publiku (RTSH Kuvendi, Faqja e Kuvendit dhe Rrjetet Sociale të Kuvendit) brenda vitit 2024.</p> <p>d) Hartimit të një plani pune për arritjen e standardeve dhe treguesve të transparencës deri në vitin 2025.</p> <p>e) Zbatimi të plotë të sistemit të E-Legjislationit që do të integrojë sistemet e të gjitha institucioneve të përfshira në procesin ligjvënës si dhe forcimin e kapaciteteve administrative të Kuvendit nëpërmjet trajnimeve për të përballuar rritjen e përgjegjësiave për çështjet e transparencës që dalin nga procesi i anëtarësimit brenda 2024-2028.</p> <p>Rritja e përfshirjes së OSHC-ve dhe grupeve të interesit në mbledhjet e komisioneve parlamentare gjatë procesit ligjvënës dhe mbikëqyrës si dhe gjatë ushtrimit të funksionit zgjedhor të Kuvendit duke filluar nga viti 2024 e në vazhdim.</p> <p>Rritja e numrit të projektligjeve të konsultuara në platformën e projektligjeve në përputhje me Rregulloren e Kuvendit gjatë periudhës 2024-2027 duke përmirësuar platformën për konsultimin e projektligjeve, duke publikuar udhëzime elektronike miqësore për përdoruesit dhe organizuar fushata sensibilizuese.</p> <p>Rritja e përfshirjes së OSHC-ve dhe grupeve të interesit në mbledhjet e Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian dhe ndjekje transparente e rekomandimeve dhe/ose çështjeve të ngritura nga palët e interesuara në mbledhjet e KKIE duke filluar nga viti 2024 e në vazhdim.</p> <p>Organizimi i proceseve të zgjedhjeve/emërimeve të kryetarëve dhe anëtarëve të institucioneve të pavarura sipas afateve ligjore dhe vendeve vakante të krijuara, pa vonesa dhe duke siguruar zbatimin e parimeve të paanshmërisë, pavarësisë dhe transparencës duke filluar nga viti 2024 e në vazhdim.</p> <p>Ushtrimi sistematik i funksionit mbikëqyrës të Kuvendit ndaj veprimtarisë së qeverisë, lidhur me zbatimin e ligjeve dhe politikave, duke rritur përdorimin e instrumenteve të kontrollit nga deputetët (pyetje, interpelanca, seancat e komisioneve hetimore, mocionet, vizitat etj.) dhe duke organizuar takime periodike të përbashkëta mes Parlamentit, Qeverisë dhe institucioneve të</p>	<p>Kodi i Sjelljes i ndryshuar dhe zbatuar nga deputetët.</p> <p>Rregullorja e Kuvendit e ndryshuar dhe e zbatuar për sa i përket kontrollit <i>post-legjislativ</i> jo vetëm për ligjet e përafuara me <i>acquis</i>-in e BE-së, por edhe për aktet normative që kanë fuqinë e ligjit deri në vitin 2024.</p> <p>Metodologjia për kontrollin <i>post-legjislativ</i> miratohet dhe stafi i Kuvendit trajnohet për zbatimin e saj deri në vitin 2025.</p> <p>Disponueshmëri dhe qasje në dokumentacionin zyrtar parlamentar për shoqërinë civile, median, palët e tjera të interesuara dhe publikun e gjerë në kohën e duhur dhe të përshtatshme për përdoruesit, duke përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara.</p> <p>Sistemi i transkriptimit i cili do të mundësojë qartësimin sa më të shpejtë të materialit audio për mbledhjet e komisioneve parlamentare dhe seancat plenare funksionon plotësisht dhe efektivisht sa më shpejtë të jetë e mundur dhe me standarde më të larta deri në fund të vitit 2028.</p> <p>Transmetim në kohë reale dhe qasje në materialet audio-video të veprimtarisë parlamentare në çdo kohë nga publiku.</p> <p>Standardet dhe treguesit e parashikuar në dokumentin e transparencës zbatohen plotësisht deri në vitin 2028.</p> <p>Procedura legjislativë më të shpejta dhe efektive mundësohen përmes digitalizimit dhe përmirësimit të proceseve të brendshme brenda vitit 2029 dhe fuqizimi i kapaciteteve administrative të Kuvendit me synimin për të përballuar rritjen e përgjegjësiave për çështjet e transparencës që dalin nga procesi i anëtarësimit brenda viteve 2024 -2029.</p> <p>Sistemi i legjislationit elektronik zbatohet plotësisht deri në vitin 2028.</p> <p>Përfshirja e aktorëve më të gjerë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit në punën e Kuvendit përmirësohet dhe forcohet brenda vitit 2028.</p> <p>Rritje e numrit të projektligjeve të konsultuara përmes platformës për konsultimin e projektligjeve.</p> <p>Shkëmbim kuptimplotë dhe sistematik me përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe grupet e interesit gjatë takimeve të KKIE-së për diskutimin e dokumenteve të ndryshme.</p> <p>Zgjedhja/emërimi i kryetarëve dhe anëtarëve të institucioneve të pavarura sipas afateve ligjore dhe vendeve vakante të krijuara.</p> <p>Një rol proaktiv dhe i zgjeruar i Kuvendit për të kontrolluar punën e qeverisë, monitoruar institucionet e pavarura dhe për të mbikëqyruar nivelin e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura.</p> <p>Organizimi i sesioneve informuese me deputetët e rinj për instrumentet e</p>
--	--	---	---

¹ Në faqen zyrtare të Kuvendit (<https://parlament.al>) problemet me hyrjen <https://api> me certifikatat janë zgjidhur. Faqja është konfiguruar siç duhet me certifikatat e serverit.

	<p>Procedurat e emërimit mirorientohen për të siguruar emërimin nga Kuvendi në kohë të anëtarëve të institucioneve dhe autoriteteve të pavarura si: Autoriteti i Konkurrencës, Banka e Shqipërisë, Avokati i Popullit duke filluar nga viti 2024 e në vazhdim.</p>	<p>pavarura për të diskutuar dhe mbikëqyrur nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga institucionet e pavarura për punën e qeverisë dhe të institucioneve në varësi të saj duke filluar nga viti 2024 e në vazhdim.</p> <p>Forcimi i mbikëqyrjes ndaj institucioneve të pavarura përmes:</p> <p>a) Organizimit të seancave dëgjimore në komisionet parlamentare me institucionet e pavarura përgjatë diskutimeve mbi raportet e dërguara prej tyre për çështje të ndryshme duke filluar nga viti 2024 e në vazhdim.</p> <p>b) Shqyrtimit nga Kuvendi/ Komisionet e Përhershme Parlamentare të raporteve vjetore të institucioneve të pavarura, duke zbatuar procedurat dhe afatet ligjore për raportimin në Kuvend dhe miratimin e një rezolute për secilën prej tyre me rekomandime specifike që duhen ndjekur dhe zbatuar për vitin në vijim duke filluar nga viti 2024 e në vazhdim.</p> <p>c) Përmirësimit/përditësimit të Platformës ndërinstitucionale online deri në vitin 2025.</p> <p>d) Ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të 6 (gjashtë) institucioneve të pavarura ndaj palëve të treta dhe organizimi i seancave dëgjimore në komisionet/ose nënkomisionet parlamentare përgjegjëse.</p>	<p>kontrollit dhe monitorimit të përcaktuara nga rregulloja e Kuvendit dhe ligji për rolin e parlamentit në procesin e integritetit në BE, i ndryshuar, në ushtrimin e rolit mbikëqyrës dhe monitorues ndaj qeverisë dhe institucioneve të pavarura brenda vitit 2025.</p> <p>Sigurimi i ndjekjes efektive të rekomandimeve të organeve të pavarura nga viti 2024 e në vazhdim.</p> <p>Platforma Ndërinstitucionale Online plotësisht funksionale dhe më e kuptueshme për përdoruesit (miqësore për përdoruesit).</p>
<p>2.2 Integriteti Kodet etike; deklarami i pasurisë; regjimet për parandalimin e konfliktit të interesit; kufijtë e imunitetit nga hetimi, ndjekja penale ose gjykimi i veprave të korrupsionit në shkallën e nevojshme në një shoqëri demokratike.</p>	<p>Sigurimi i harmonizimit të plotë me standardet ndërkombëtare për lufimin e ryshfetit të zyrtarëve publikë të huaj nëpërmjet ratifikimit të Konventës së OECD-së për Lufimin e Ryshfetit të Zyrtarëve Publikë të Huaj në Transaksionet e Biznesit Ndërkombëtar të 17 dhjetorit 1997, brenda vitit 2027.</p> <p>Standarde më të larta etike të deputetëve në Kuvend gjatë zbatimit të Kodit të Etikës për deputetët dhe në përputhje me praktikën e mira të shteteve anëtare të BE-së të siguruar deri në vitin 2027.</p>	<p>Zbatimi i Kodit të Sjelljes për deputetët nëpërmjet caktimit të masave disiplinore në rastet e shkeljes së dispozitave të Kodit në komisione dhe seanca plenare duke:</p> <p>a) Rritur transparencën e organeve vendimmarrëse në vendosjen e masave disiplinore për deputetët nëpërmjet publikimit në faqen e Kuvendit të: i) vendimeve dhe ii) procesverbalit të mbledhjes dhe iii) edhe statistikave periodike për zbatimin e Kodit të Sjelljes së deputetëve brenda vitit 2025.</p> <p>b) Organizuar sesione informuese me deputetët e rinj për çdo legjislaturë të re për zbatimin e Kodit të Etikës ose për çështjet etike në përputhje me praktikën më të mira të fushës dhe duke u ofruar këshilla të vazhdueshme për çështjet e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës si deputetë nga viti 2024 e në vazhdim.</p> <p>Finalizimi i draft metodologjisë për identifikimin e riskut për korrupsion në procesin ligjbërës dhe trajnimi i stafit të Kuvendit për zbatimin e saj brenda vitit 2026.</p> <p>Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative të Kuvendit për mbështetjen e deputetëve në tema të lidhura me konfliktin e interesave, çështjet etike etj., duke marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga ILDKPKI apo partnerë të tjerë nga viti 2024 e në vazhdim.</p>	<p>Ratifikimi i Konventës së OECD-së për Luftën kundër ryshfetit të zyrtarëve publikë të huaj në transaksionet e biznesit ndërkombëtar të 17 dhjetorit 1997 brenda 2027.</p> <p>Standarde më të larta etike dhe integriteti të punimeve të Kuvendit përmirësohen në mënyrë progresive deri në vitin 2028.</p> <p>Identifikimi i riskut për korrupsion në procesin ligjbërës si një nga elementët e opinioneve të shërbimit ligjor për deputetët nga viti 2026 e në vazhdim.</p> <p>Forcimi i kapaciteteve administrative të Kuvendit për mbështetjen e deputetëve në tema për konfliktin e interesave, çështje etike, vlerësimin preventiv të korrupsionit etj., brenda vitit 2027.</p>
<p>2.3 Efektiviteti Organizimi i përgjithshëm i punimeve të Kuvendit dhe përputhshmëria me normat dhe vlerat demokratike. Në veçanti, kryerja efektive e funksioneve të funksioneve të kontrollit; roli i mazhorancës dhe opozitës; gjithëpërfshirja në funksionet ligjbërëse, duke përfshirë rolin e palëve të interesuara.</p>	<p>Ndryshimi i kuadrit ligjor për të përfshirë koncepte si marrëdhëniet mes Kuvendit të Shqipërisë dhe Parlamentit Evropian, parimi i subsidiaritetit në përputhje me Rregulloren e Punës së Parlamentit Evropian, 1 vit përpara aderimit.</p> <p>Ndryshimi i Kushtetutës që garanton respektimin e parimit të supremacisë së ligjit të BE-së mbi të gjitha dispozitat që bien ndesh në legjislacionin kombëtar, nga institucionet demokratike, duke përfshirë Kuvendin, Qeverinë, si dhe autoritetet gjyqësore, 6 muaj përpara aderimit.</p> <p>Ndryshimi i nenit 28 të ligjit për Avokatin e Popullit, shfuqizimin e detyrimit për publikimin e raportit vjetor të Avokatit të Popullit vetëm pas paraqitjes së tij në Kuvend, brenda vitit 2024.</p>	<p>Sistemi elektronik i Legjislacionit që do të integrojë sistemet e të gjitha institucioneve të përfshira në procesin ligjbërës, zbatohet brenda periudhës 2024-2028.</p> <p>Forcimi i kapaciteteve të stafit administrativ dhe politik të Kuvendit në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara për mbështetjen e deputetëve, për të përballuar detyrimet e shtuara që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit brenda vitit 2029.</p> <p>Përmirësimi i dialogut politik për të minimizuar ndikimin e polarizimit politik në efektivitetin e punës së Kuvendit nëpërmjet organizimit të takimeve periodike ndërmjet Kryetarit të Kuvendit dhe krerëve të grupeve parlamentare, për diskutimin e çështjeve që kërkojnë një konsensus të gjerë nga viti 2024 e në vazhdim.</p> <p>Përmirësohet roli mbikëqyrës i Kuvendit mbi ekzekutivin duke rritur përdorimin e instrumenteve të kontrollit nga deputetët (pyetje, interpelanca, seanca dëgjimore në komisionet parlamentare, mocione, vizita, komisione hetimore etj.) dhe duke rritur aktivitetet e nënkomisioneve parlamentare nga 2024 e në vazhdim.</p> <p>Rritje e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të</p>	<p>Konceptet e tilla si marrëdhëniet mes Kuvendit të Shqipërisë dhe Parlamentit Evropian dhe parimi i subsidiaritetit janë në përputhje me Rregulloren e Punës të Parlamentit Evropian.</p> <p>Parimi i supremacisë së ligjit të BE-së është pjesë e dispozitave të Kushtetutës.</p> <p>Procedura legjislative më të shpejta dhe efektive të mundësuar përmes digjitalizimit dhe përmirësimit të proceseve të brendshme brenda vitit 2029.</p> <p>Përmirësohet cilësia e shërbimeve të ofruara për deputetët nga stafi administrativ dhe politik për të përballuar detyrimet e shtuara që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit brenda vitit 2029.</p> <p>Dialogu politik përmirësohet duke u siguruar efektivitet më të lartë të Kuvendit.</p>

		raporteve të auditit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nga viti 2024 e në vazhdim.	Raporti i vjetor i Avokatit të Popullit publikohet para se Kuvendi të mbajë debat për të.
<p>3. ROLI I SHOQËRISË CIVILE <i>Kornizat kombëtare ligjore, rregullatore dhe të politikave për OJQ-të për të vepruar brenda (përfshirë kushtet për regjistrim, taksat, mekanizmat e konsultimit etj.) dhe konteksti politik sigurojnë një mjedis të favorshëm për shoqërinë civile.</i></p>			
<p>3.1 Kuadri i përgjithshëm për shoqërinë civile Kuadri ligjor, politik dhe institucional, pajtueshmëria me instrumentet dhe standardet përkatëse ndërkombëtare, strategjitë publike për të promovuar hapësirën qytetare dhe krijuar një mjedis të favorshëm për zbatimin dhe fuqizimin e kapaciteteve, funksionimin dhe performancën, sfidat dhe mangësitë</p>	<p>Mandati institucional qeveritar për koordinimin e politikave të shoqërisë civile (përfshirë zbatimin e Udhërrëfyesit) qartësohet deri në mesin e vitit 2024 (nëpërmjet VKM-së).</p> <p>Kuadri legjislativ për Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile i ndryshuar për të përmirësuar funksionimin, përbërjen e tij dhe për të siguruar një përfshirje më të madhe të institucioneve publike dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile për të reflektuar ndryshimet në portofolat ministrorë dhe përfaqësimin në Këshill do të miratohet nga Këshilli i Ministrave në vitin 2024 dhe nga Parlamenti në 6 muajt e parë të vitit 2025.</p> <p>Bashkëpunim i rregullt dhe efektiv i institucionalizuar ndërmjet Qeverisë dhe shoqërisë civile me pjesëmarrje domethënëse të OSHC-ve në proceset vendimmarrëse, duke i përfshirë në kontekstin e negociatave të anëtarësimit në BE brenda vitit 2024</p> <p>Publikimi, konsultimi dhe miratimi i raportit të vlerësimit të monitorimit për udhërrëfyesin 2019-2023 për krijimin e një mjedisi favorizues për OSHC-të brenda vitit 2024.</p> <p>Publikimi, konsultimi dhe miratimi i Udhërrëfyesit të ri për mjedisin mundësues për OSHC-të 2024-2027 realizohet brenda vitit 2024.</p>	<p>Këshilli Kombëtar është plotësisht transparent funksional dhe i kapaciteteve, duke përfshirë shpërndarjen e burimeve të nevojshme financiare dhe kapaciteteve njerëzore.</p> <p>Rritja e kapaciteteve dhe burimeve të mekanizmit monitorues të udhërrëfyesit të miratuar për një mjedis të favorshëm për shoqërinë civile brenda vitit 2024.</p> <p>Procedurat administrative për menaxhimin e të gjitha fondeve publike (përfshirë Agjencinë Kombëtare për Mbështetjen e Shoqërisë Civile) përmirësohet brenda vitit 2025 dhe financimi publik rritet për t'u mundësuar OSHC-ve të kryejnë rolet e tyre si ofrues shërbimesh që nga viti 2026.</p> <p>Funksionaliteti i plotë i platformës online për ndjekjen e procesit të granteve aktivizohet brenda vitit 2025.</p>	<p>Puna e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile fuqizohet dhe bëhet më transparente duke mundësuar shprehjen më të mirë të prioriteteve të OSHC-ve në proceset e politikëbërjes.</p> <p>OSHC-të marrin mbështetje përmes fondeve shtetërore të mundësuar nga procedura të shpejta dhe transparente brenda vitit 2025 e në vazhdim.</p>
<p>3.2 Kornizat kombëtare ligjore, rregullatore dhe të politikave për organizatat e shoqërisë civile (OSHC)</p> <p>Këtu përfshihen kushtet për regjistrim, zbatimin i lirisë të shoqatës, mekanizmat për të parandaluar ndërhyrjet dhe presionet e padrejta mbi aktivitetet dhe anëtarët e OSHC-ve, kushtet për taksimin dhe aksesin në financim/burime etj. kapacitetet e zbatimit, sfidat dhe mangësitë.</p>	<p>Një sistem regjistrimi elektronik më i shpejtë dhe më transparent për OSHC-të i sigurohet deri në vitin 2024.</p> <p>Analizë e legjislacionit në lidhje me sigurimin e një mjedisi tatimor më të favorshëm si për donacionet e kompanive ashtu edhe për ato individuale për OSHC-të deri në vitin 2025.</p> <p>Bërja efektive e regjimit të përjashtimit nga TVSH-ja për OSHC-të në përputhje me ligjin e rishikuar të TVSH-së sigurohet nga viti 2024 e në vazhdim.</p> <p>Miratimi i ligjit të rishikuar të sponsorizimit të lidhje me stimujt tatimorë për donacionet në përputhje me shembujt e praktikave më të mira të BE-së, deri në vitin 2027.</p>	<p>Sigurohet i funksionimit efektiv i sistemit digjital për regjistrimin e OSHC-ve brenda vitit 2024 dhe adresohen nevojat për kapacitete të Këshillit të Lartë Gjyqësor.</p> <p>Ndërveprueshmëria e sistemit digjital për regjistrimin e OSHC-ve ndërmjet KLGJ-së (Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë), Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, si dhe aksesit i plotë në regjistrin e OSHC-ve sigurohen nga Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit brenda vitit 2024.</p> <p>Rritja e kapaciteteve të sektorit të Mbështetjes së Zbatimit të Projekteve në SASPAC për të finalizuar shqyrtimin e certifikatave për OSHC-të që përfitojnë nga regjimi i përjashtimit nga TVSH-ja duke filluar nga viti 2024 e në vazhdim.</p> <p>Fushata ndërgjegjëse të organizuara nga SASPAC me të gjithë aktorët e përfshirë në lidhje me procedurat vijuese për regjimin e përjashtimit nga TVSH-ja nga viti 2024 e në vazhdim.</p> <p>Kapacitetet e organeve tatimore për të përballuar procedurat e përjashtimit të OSHC-ve që zbatojnë kuadrin ligjor të miratuar në janar 2023, rriten deri në vitin 2025.</p>	<p>Sigurohet transparencë dhe kontroll më i madh publik mbi statusin dhe anëtarësimin e OSHC-ve brenda vitit 2025.</p> <p>Mjedis i favorshëm tatimor për OSHC-të, duke përfshirë përjashtimin nga TVSH-ja, siç parashikohet në ligjin shqiptar të TVSH-së në fuqi, plotësisht funksional dhe i zbatuar në mënyrë efektive deri në vitin 2025.</p>

		<p>Rritja e kapaciteteve të organeve tatimore për ndjekjen efektive të personave juridikë (OSHC) të përjashtuara nga TVSH-ja brenda vitit 2025.</p> <p>Rritja e kapaciteteve monitoruese të organeve tatimore në monitorimin e regjistrat të OSHC-ve përfituese të certifikuara brenda vitit 2025</p>	
<p>3.3 Konteksti më i gjerë për mjedisin e favorshëm</p> <p>Kuadri ligjor, politik dhe institucional, pajtueshmëria me instrumentet dhe standardet përkatëse ndërkombëtare, zbatimi, funksionimi dhe performanca, sfidat dhe mangësitë. Ky kuadër përfshin sigurimin e pjesëmarrjes efektive të OSHC-ve dhe qytetarëve në politikbërje, përgjegjshmërinë publike, mekanizmat e konsultimit, bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve publike dhe funksionimin e strukturave dialoguese mes autoriteteve shtetërore dhe OSHC-ve.</p>	<p>Korniza ligjore e rishikuar për vullnetarizmin miratuar brenda vitit 2025.</p> <p>Metodologjia e akteve që i nënshtrohen konsultimeve publike është rishikuar dhe miratuar brenda vitit 2030 duke zgjeruar fushën e konsultimit publik për aktet e qeverisë.</p> <p>Ndryshim në ligjin nr. 146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik", dhe në legjislacionin dytësor për konsultimin publik në mënyrë progresive drejt vitit 2030.</p> <p>Kuadri ligjor që do të ndryshohet për të siguruar përshtatjen e afatit të publikimit për konsultimin elektronik bazuar në kompleksitetin dhe rëndësinë e nismave komplekse të politikave.</p> <p>Të 33 platformat e Partneritetit të Integritit Evropian (1 për çdo kapitull) të krijuara duke siguruar pjesëmarrjen e plotë të shoqërisë civile në procesin e negociatave deri në vitin 2024.</p>	<p>Zbatimi dhe monitorimi i plotë i kuadrit të rishikuar për iniciativat vullnetare (vullnetarizmin) brenda vitit 2026.</p> <p>Rriten kapacitetet e ministrave të linjës për të kryer konsultimet e duhura brenda vitit 2025.</p> <p>Kuvendi përmirëson mjetet digjitale për të siguruar një konsultim më të madh publik të duhur nga viti 2026 e në vijim.</p> <p>Rritja e cilësisë së raporteve të konsultimit publik dhe plotësimit i strukturave përgjegjëse me staf të kualifikuar dhe të mirë trajnuar si kusht për zgjerimin e procesit të konsultimit publik në legjislacionin dytësor me interes të lartë publik deri në vitin 2030.</p> <p>Rritja e kapaciteteve të të 33 tabelave të diskutimit të EIPP deri në vitin 2025.</p>	<p>Cilësia e konsultimeve, transparenca dhe pjesëmarrja publike e OSHC-ve në proceset vendimmarrëse përmirësohet duke u drejtuar në mënyrë proaktive dhe plotësisht gjithëpërfshirëse, dhe shtrirë në të gjitha iniciativat legjislativë dhe politike duke u realizuar përmes mekanizmeve efektive institucionale dhe për një dialog brenda vitit 2025.</p> <p>Forcimi i kulturës pjesëmarrëse të publikut dhe palëve të interesuara dhe rritja e llogaridhënies së institucioneve në vendimmarrje përmes konsultimit publik që çon në rregullime më të mira brenda vitit 2026</p> <p>Administrata publike në Qendrën e Qeverisjes është e aftë të kryejë procesin e konsultimit publik bazuar në standardet më të larta – në vazhdim.</p> <p>Afati i publikimit për konsultimin elektronik respektohet së paku në nivelin 90 %</p> <p>Shoqëria civile konsultohet plotësisht dhe merr pjesë në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse në negociatat e anëtarësimit në BE nga viti 2025.</p>